

Përgjigje pozitive kundrejt sjelljeve të papërshtatshme

Përgjigjet verbale

1. Thirrja me emër Flisni gjithmonë në mënyrë pozitive kur zgjidhni t`i drejtoheni njw nxënësi me emër	-Ana, ti do përgjigjesh për ushtrimin tjetër. Je duke punuar shumë mirë, por duhet të përdorësh një zë më të ulët.
2. Përdorni shënimet përkujtuese	-Vendosni letra me shënime pranë tavolinës së çdo nxënësi -Krijoni mënyra të dukshme që iu kujtojnë nxënësve distancimin nga sjelljet e papërshtatshme
3. Përdoni fjali përshkruese	-Jemi afër kohës së pushimit! -Keni edhe 7 minuta kohë për të përfunduar detyrat! -Orës tjetër do ndërrojmë klasë.
4. Përdorni pohime përforcuese	-Është e nevojshme që të rri në qetësi, në mënyrë që të vazhdojmë leximin. -Duhet të ngrej më dorën që ta marrim lehtë për të folur.
5. Bëni pyetje për të kuptuar sjelljen e papërshtatshme	-Emi, besoj se ti e di që duke bërë zhurmë shqetëson të tjerët? -Vilma, ka ndonjë arsye që po flet me zë të lartë?
6. Lejoni nxënësit që të bëjnë zgjedhje	-Dëshiron që të punosh në grup apo vetëm? -Si doni që të uleni sot, në formë rrethore apo në rresht? -Cilin ushtrim do zgjidhim të parin?
7. Shmangni objektet që tërheqin vëmendje	Pasi keni arritur të kuptoni arsyet e sjelljeve të papërshtatshme, përpiquni të minimizoni objektet apo

	mënyrat e tjera që sjellin shpërqëndrim tek nxënësit
8. Ndërveproni pozitivisht	Rrisni raportet e ndërveprimit pozitiv me nxënësit. Në këtë mënyrë, jeni duke iu treguar edhe mënyrën sesi duhet të sillen apo të zgjidhin problemet.
9. Përsëri në mënyrë të vazhdueshme rregullat	-Qëndrojmë në qetësi -Respektojmë njëri-tjetrin
10. Shpjegoni arsyet e vendosjes së rregullave	-Ne e kemi vendosur këtë rregull sepse duke qënduar ne qetësi mund të dëgjojmë mësim dhe njëri-tjetrin.
11. Përdorni vlerësimin Në mënyrë sistematike, kërkoni nga nxënësit që të vlerësojnë veten.	-Le të shikojmë rregullat dhe të vlerësojmë sesi jemi sjellë sot...
12. Drejtoni nxënësit Rikujtojuni nxënësve detyrat që ata kanë. Përpiquni që të shmangni komentet për sjelljet e papërshtatshme.	-Çfarë detyre të është caktuar? -Sa pjesë të teksit ke lexuar?
13. Përdorni teknikën e ndërrimit të vendeve për të minimizuar sjelljen e papërshtatshme	-Mishel, të lutem zgjidh një vend tjetër ku mund të përqëndrohesh më mirë.
14. Ofroni ndihmë	-Ema, dëshiron që të të ndihmoj? -Maria, do që ta fillojmë ushtrimin bashkë?
15. Përdorni të dëgjuarin akiv Dëgjoni dhe perifrazoni fjalët e nxënësve	-Pra ti je i mërzhitur sepse...
16. Përdorni lavdërimet Njihni sjelljet e mira të nxënësve nëpërmjet lavdërimeve. Në këtë mënyrë, ju jeni edhe duke demonstruar mënyrat pozitive të të vepruarit dhe bashkëvepruarit.	-Marta të përgezoi që po ec me qetësi në korridor. -Grupi i parë është duke punuar sipas udhëzimeve të dhëna.

<p>17. Buzëqeshni, reagoni, buzëqeshni</p>	<p>(buzëqeshni) Ela të lutem mos bëj zhurmë me Xhenin. Përqëndrohuni tek detyra. Faleminderit. (buzëqeshni)</p>
<p>18. Reagoni në mënyrë pozitive për të rikujtuar rregulluat.</p>	<p>Faleminderit që ngrite dorën për tu përgjigjur.</p>
<p>19. Pyesni për mënyra të tjera alternative të sjellurit</p>	<p>-Si mund të tregojmë respekt në klasë? -Çfarë propozoni që të ndihemi të sigurtë?</p>
<p>20. Krijoni një plan injorimi të sjelljeve të papërshtatshme</p>	<p>-Injoroni sjelljen e papranueshme socialisht. -Përqëndrohuni më tepër tek shpërblimi dhe përforcimi i sjelljes pozitive.</p>